

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****Në çështjen juridike të :****AC-I-22-0086-A0001***Paditësi/Ankuesi***Z.Z. "B R"**, D M, me përfaqësuese sipas autorizimit avokaten J S. I, Beograd**Kundër:***E paditura***N.SH "Lux"** (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-3694, të datës 11 tetor 2021, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 24 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktvendimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-3694, i datës 11 tetor 2021.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

**Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 11 dhjetor 2021, ankuesi kishte parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. MIT0039-0013 të datës 30 tetor 2013 me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensimin e shumës prej 12,750.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme.

Në ankesë theksohet se AL duhet të kishte parasysh situatën e vitit 1998-1999 në Kosovë dhe në pajtim me nenin 383 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore të konsideroi kërkesën si të afatshme për shkak të pengesave të pa kapërcyeshme.

Me datë 1 qershor 2017, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesë.

Me datë 9 gusht 2017, paditësi kishte paraqitur përgjigje në mbrojtjen e të paditurës.

Me datë 29 gusht 2017 e paditura kishte paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e paditësit.

Me datë 28 maj 2021, Zyrtarja për Financa kishte lëshuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për përfaqësuesen e paditësit në shumën prej 100.00 euro. Me anë të këtij njoftimi, ankuesi është paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën brenda afatit ligjor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), nenit 6.4, 6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit Administrativ 2008/2 për Unifikim të tarifave të gjykatës, ankesa do të konsiderohet e tërhequr. Gjithashtu, i njëjti është njoftuar se mund të parashtroj kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Vërejtja paditësit i ishte dorëzuar me datë 11 qershor 2021, ndërsa ankuesi deri më sot nuk e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore dhe nuk ka parashtuar kërkesë për t'u liruar nga pagesa e taksës gjyqësore.

Me datë 11 tetor 2021, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-13-3694 e kishte konsideruar ankesën e paditësit si të tërhequr. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi theksohet se gjykata përmes vërejtjes së datës 28 maj 2021 kishte kërkuar nga ankuesi që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore. Vërejtja ishte pranuar nga ankuesi/përfaqësuesi i tij me datë 11 qershor 2021 mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve e as deri me vendosjen e këtij Aktgjykimi.

Me datë 18 shkurt 2022, paditësi kishte paraqitur ankesë kundër Aktvendimit C-IV-13-3694 të datës 11 tetor 2021, për të gjitha bazat ankimore. Në ankesë theksohet se përfaqësuesi i mëhershëm i paditësit nuk e ka informuar të njëjtin për pagesën e taksës gjyqësore, ndërsa për

aktvendimin me të cilin ankesa i është konsideruar e tërhequr është njoftuar sot kur e njëjta e ka informuar se e ka dorëzuar parashtresën në muajin shtator të vitit 2021 së bashku me revokimin e autorizimit e ku ka cekur se me paditësin nuk është më në kontakt, gjë që e konfirmon edhe paditësi. Me datë 15 janar 2022, paditësi thekson se ka kontaktuar me avokaten e cila e ka njoftuar me të lartcekurat dhe nëpërmjet Viber i ka dërguar fotografitë e Aktvendimit të ankimuar. Andaj, duke u bazuar në të lartshënuarat i propozon Kolegjit të Apelit që të anuloj Aktvendimin e ankimuar dhe çështjen t’ia kthej shkallës së parë në rivendosje.

Me datë 20 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit në të cilën thekson se argumentet e ngritura në ankesë janë të përsëritura dhe propozon që ankesa e të njëjtit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Sipas nenit 253.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK): *“Paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar”*.

Në vazhdim siç me të drejtë ka theksuar edhe shkalla e parë e DHPGJS-së, neni 253.5 parasheh që: *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*.

Në bazë të nenit 3.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 (UA) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), përcaktimi i taksës gjyqësore për t’u paguar në kohën kur është paraqitur/parashtruar parashtresa, është i bazuar në vlerën e kontestit, respektivisht në natyrën e parashtresës..

Neni 2.4 i UA-së e përcakton se shprehja “parashtresë” përdoret për padi, kundërpadi, ankesë, kundërshtim, kërkesë, revizion, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, etj.

Përfaqësuesi i ankuesit pretendon se i njëjti nuk ka qenë i njoftuar për pagesën e vërejtjes gjyqësore nga përfaqësuesja e tij dhe se përfaqësuesja e tij e kishte njoftuar që në shtator të vitit 2021 kishte dorëzuar në gjykatë në parashtrësë me anë të së cilës kishte bashkëngjitur revokimin e autorizimit e ku ka theksuar se me paditësin nuk është më në kontakt.

Kolegji i Apelit konsideron se ankuesi përveç pretendimeve të tij të paraqitura në ankesë nuk ka bashkëngjitur as edhe një provë të vetme në mbështetje të këtyre pretendimeve e të cilat do të ndikonin në vendosjen ndryshe të kësaj ankese.

Tutje, Kolegji i Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se Zyrtarja e Lartë për Financa me datë 28 maj 2021 kishte nxjerrë Vërejtjen për Pagesën e Taksave Gjyqësore në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, në shumë prej 100.00 € (njëqind Euro) në të cilin Njoftim (Vërejtje) kishte njoftuar ankuesin se në rast të mos pagesës së taksës padia do të konsiderohet e tërhequr.

Nga shkresat e lëndës mund të shihet se vërejtja ishte pranuar nga ana e paditësit me datë 11 qershor 2021, mirëpo paditësi deri më sot nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe as nuk kishte paraqitur kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore.

Prandaj, pasi që ankuesi nuk e ka paguar taksën gjyqësore siç është kërkuar nga ai me njoftimin (vërejtjen) e datës 28 maj 2021, që është dorëzuar tek ankuesi me datë 11 qershor 2021 dhe nuk ka paraqitur kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë e DHPGJS-së ka vepruar drejtë kur ka konsideruar si të tërhequr ankesën e ankuesit.

Duke u bazuar në të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumë prej 100 euro me datë 13/04/2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 24 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_